

## RELACION

PËR

### PROJKEKTVENDIMIN

PËR

#### PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA DHE PROCEDURAVE PËR PËRGJEDHJEN, EMËRIMIN, VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË PUNË, DISIPLINËN, LIRIMIN DHE SHKARKIMIN NGA DETYRA TË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është të sigurojë një kuadër të qartë, objektiv dhe të standardizuar për përgjedhjen, emërimin, vlerësimin, disiplinimin, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektakt synon të garantojë integritetin, pavarësinë funksionale dhe profesionalizmin e pozicionit të Inspektorit të Përgjithshëm, si figura më e lartë drejtuese e sistemit të inspektimeve, përmes një procesi të bazuar në kriteret e qarta bazuar në meritë, transparence dhe llogaridhënieje.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen përmes këtij akti janë:

- Vendosja e kritereve të veçanta të **kualifikimit** dhe përvojës që duhet të përbushë çdo kandidat për pozicionin e Inspektorit të Përgjithshëm;
- Përcaktimi i procedurës së përgjedhjes dhe emërimit, duke përfshirë ngritjen e komisionit *ad hoc* dhe kriteret e vlerësimit të dokumentacionit dhe intervistës;
- Rregullimi i mënyrës së vlerësimit të rezultateve në punë, në funksion të performancës dhe objektivave institucionale;
- Përcaktimi i procedurës disiplinore dhe e drejtës për mbrojtje në rastet e nisjes së hetimit administrativ për shkelje të mundshme;
- Saktësimi i rregullave dhe procedurës për lirimin ose shkarkimin nga detyra, në funksion të garantimit të llogaridhënieve dhe respektimit të ligjit.

Projektakti forcon besueshmërinë dhe integritetin e institucionit të Inspektoratit të Përgjithshëm, si dhe kontribuon në zhvillimin e një sistemi inspektimi efikas, të përgjegjshëm dhe të drejtë.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e kritereve të veçanta dhe procedurave për përgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm”.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim vjen në zbatim të nenit 16, pika 2 të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe mbështet objektivat e programit të qeverisë për rritjen e integritetit dhe llogaridhënisë në administratë. Gjithashtu, ky projektakt është në përputhje me Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2025.

Projektakti është pjesë integrale e reformës institucionale në fushën e inspektimeve, duke fuqizuar zbatimin e ligjit dhe përmirësuar qeverisjen në administratës publike.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ky projektvendim vjen në funksion të zbatimit të nenit 16, pika 2, të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, **dhe** ka për qëllim të plotësojë kuadrin rregullator lidhur me procesin e përzgjedhjes, emërimit, vlerësimit të rezultateve në punë, disiplinës, lirimit dhe shkarkimit nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm. Përcaktimi i detajuar i këtyre procedurave dhe kritereve kontribuon në rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe garantimin e një funksionimi të qëndrueshëm të sistemit të inspektiveve në vend.

Problematikat që adreson projektakti:

- Mungesa e një akti të veçantë që të specifikojë kriteret shtesë të kualifikimit profesional dhe përvojës për pozicionin e Inspektorit të Përgjithshëm;
- Mungesa e një procedure të detajuar dhe transparente për përzgjedhjen dhe vlerësimin e kandidatëve për këtë funksion të lartë shtetëror;
- Mungesa e rregullave të qarta për trajtimin e rasteve të shkeljeve disiplinore dhe për ndërmarrjen e masave të pezullimit apo shkarkimit nga detyra;
- Mungesa e një metodologjie të bazuar në performancë për vlerësimin e punës së Inspektorit të Përgjithshëm.

Përparësitë e projektaktit:

- Vendosja e një procedure të qartë **dhe** të standardizuar për përzgjedhjen dhe vlerësimin e kandidatëve, duke garantuar meritë, integritet dhe transparencë;
- Krijimi i një mekanizmi të paanshëm vlerësues përmes ngritjes së një komisioni *ad hoc* me përfaqësues institucionalë dhe akademikë;

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e kritereve të veçanta dhe procedurave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm”.

- Formalizimi i kritereve të arsimit, përvojës dhe integritetit profesional për kandidatin që do të drejtojë Inspektoratin e Përgjithshëm;
- Përcaktimi i një procedure të qartë **dhe** të drejtë përmarrjen e masave disiplinore, përfshirë hetimin administrativ, dëgjesën dhe të drejtën përfaqësim ligjor;
- Krijimi i bazës përllogaridhënie dhe vlerësimi të performancës, në përputhje me objektivat institucionale dhe parimet e mirëqeverisjes.

Efektet e pritshme:

- Rritja e cilësisë së përzgjedhjes së Inspektorit të Përgjithshëm si drejtues i një strukture kyçë në zbatimin e reformës së inspektimeve;
- Sigurimi i stabilitetit institucional **dhe** funksionimit të pandikuar politikisht të Inspektoratit të Përgjithshëm;
- Rritja e besueshmërisë publike në institucionet inspektuese dhe forcimi i rolit të tyre në mbrojtjen e interesit publik;
- Zbatimi efektiv i parimeve të llogaridhënieve, kontrollit të brendshëm dhe transparencës në drejtimin e sistemit të inspektimeve.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektakti është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës, ligjin nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi që rregullon organizimin e administratës shtetërore.

Ai harmonizohet me parimet themelore të funksionimit të administratës publike dhe nuk bie ndesh me asnjë dispozitë tjeter ligjore në fuqi.

Gjithashtu, ky projektakt nuk përbën një **akt** nënligjor që sjell përfitime shtesë për subjektet e përfshira dhe, për pasojë, nuk bie ndesh me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimin përkatës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky vlerësim mbështetet në sqarimet e dhëna në shkresën zyrtare të KQZ-së, nr. prot. 1546, datë 03.03.2025, mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregulator, të ndryshuar.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE***

Projektvendimi nuk synon përafrim të drejtpërdrejtë me *acquis communautaire*, por mbështet objektivat e mirëqeverisjes dhe forcimit të kapaciteteve institucionale që përputhen me parimet e administratës evropiane.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e kritereve të veçanta dhe procedurave përpërzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm”.

Projektvendimi “Për caktimin e kritereve të veçanta dhe procedurave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm” është i ndarë në krerë dhe dispozita që rregullojnë në mënyrë të plotë procesin e përzgjedhjes dhe ndjekjes së karrierës së kësaj figure të lartë institucionale.

Projektvendimi përmban 5 krerë, të strukturuar, si më poshtë:

Kreu I – Dispozitat e përgjithshme, parashikon qëllimin e projektaktit, i cili lidhet me zbatimin e nenit 16 të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe përcakton që objekti i këtij vendimi është rregullimi i kritereve të veçanta dhe procedurave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e performancës, vendosjen e masave disiplinore, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm.

Kreu II – Kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin, përcakton kushtet shtesë që duhet të plotësojë kandidati për Inspektor të Përgjithshëm, përvèç atyre të parashikuara në ligj, duke përfshirë nivelin arsimor, fushat përkatëse të studimit dhe përvojën e nevojshme drejtuese në institucionet e inspektimit.

Kreu III – Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit, përshkruan hapat e procesit të aplikimit dhe vlerësimit të kandidatëve, nga shpallja publike e pozicionit vakant deri në renditjen përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar. Në këtë kre përfshihet ngritja e komisionit ad hoc, përbërja e tij, dokumentacioni që duhet paraqitur nga kandidatët, skema e pikëzimit dhe rregullat e funksionimit të komisionit. Gjithashtu, përcaktohet se emërimi i Inspektorit të Përgjithshëm bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit.

Kreu IV – Masat disiplinore dhe procedura për shkarkimin, rregullon mënyrën e fillimit të hetimit administrativ, të drejtën e mbrojtjes së Inspektorit të Përgjithshëm, kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm për pezullim të përkohshëm nga detyra dhe ngritjen e grupit hetimor për vlerësimin e rastit. Parashikohen gjithashtu afatet për shqyrtim dhe përgatitjen e raportit përfundimtar që i paraqitet Kryeministrit.

Kreu V – Lirimi dhe shkarkimi nga detyra, sanksionon kompetencën e Këshillit të Ministrave për të vendosur për lirimin ose shkarkimin e Inspektorit të Përgjithshëm, me propozim të Kryeministrit, në përputhje me rastet dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 99/2024.

Projektakti është hartuar me qëllim krijimin e një kuadri të quartë, të strukturuar dhe të paanshëm për menaxhimin e karrierës së Inspektorit të Përgjithshëm, duke garantuar profesionalizëm, përgjegjshmëri dhe integritet institucional në funksionin e drejtimit të sistemit të inspektiveve në nivel kombëtar.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e kritereve të veçanta dhe procedurave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm”.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Kryeministria, në cilësinë e organit propozuese për emërimin dhe lirimin/shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm, në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Sekretari i Përgjithshëm, i cili përgjigjet për shpalljen e thirrjes për aplikim, ngritjen e komisionit *ad hoc*, zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes dhe vlerësimit, si dhe për ndjekjen e procedurave disiplinore dhe të shkarkimit, sipas këtij vendimi;
- Departamenti i Administratës Publike, për caktimin e përfaqësuesit të tij në komisionin e përzgjedhjes dhe për garantimin e zbatimit të parimeve të meritës dhe transparencës në procesin e vlerësimit;
- Inspektorati i Përgjithshëm, për zbatimin në praktikë të vendimit dhe bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Inspektorati i Përgjithshëm, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, në kuadër të zbatimit të *Urdhrit nr. 49, datë 26.03.2025, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit drejtues ndërinstitucional të punës dhe grupeve teknike ndërinstitucionale për riorganizimin dhe ristrukturimin e inspektorateve në Republikën e Shqipërisë, për hartimin e projektakteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit për inspektimin, si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit elektronik të inspektimeve ‘e-Inspektimi’”.*

Në funksion të përgatitjes së këtij projektakti, janë zhvilluar gjithashtu konsultime me përfaqësues të inspektorateve shtetërore/qendrore, me qëllim pasqyrimin e nevojave praktike dhe të përvojës së tyre në zbatimin e dispozitave ligjore.

Gjithashtu, projektakti do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Departamentin e Administratës Publike, Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e kritereve të veçanta dhe procedurave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm”.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektakti nuk shoqërohet me kosto financiare për buxhetin.

### **PROPOZUESI**

**MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KËMËN E BIZNESIT**

**DELINA IBRAHIMAJ**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e kritereve të veçanta dhe procedurave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm”.